

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

nacional

Drejtor:
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com nacionalalbania@gmail.com



faqe 3

Dy fjalë lamtumire

Në trashëgimin poetike prej gjithësejt 389 poemash të Uollt Uitmanit (1819-1892), bardit amerikan të poetikës moderne botërore, në ciklin prej katër poemash me titullin "Kujtimet e Presidentit Linkolin", përndryshe Libri XXII i veprës "Fije bari", bashkë me poemat, shkruar gjatë jetës së Presidentit dhe pas largimit të tij nga jeta, "Kur çelnin jargavanët vjet te porta", "Fushave mbretëron heshnja (4 maj 1864)", dhe "Ky pluhur dikur ishte një burrë"...



faqe 18

Simbolika identitare

Në historinë e afërt të Europës viti 1968 regjistron lëvizjet e para masive të pasluftës, me çka shënohet ndërimi i brezave: brezi i ri, që nuk jeton me idealet e dikurshme të Luftës, impono-het duke ia hapur vetes rrugën me forcë dhe duke shtruar para shoqërisë kërkesa të reja: emancipim shoqëror e politik, barazi burrë-grua, heqje e dënimit me vdekje, dekolonializim. Për shqiptarët e Kosovës ky vit shënon gjithashtu ndërimin e brezave. Afirmohet një brez i ri...

EDITORIAL

Sot "Nacional"

MUJË BUÇPAPAJ

"Nacional" është revista më e re në tregun mediatik kombëtar. Një histori e shërbimit kulturor po lind me një vizion të qartë kombëtar. Prej "Flamurit të Arbërit" të De Radës e deri më sot, shumë mendje kanë lenë një pjesë të shpirtit të tyre në formimin e asaj që quhet kulturë dhe letërsi kombëtare dhe shumë të tjerë do të vijjnë pas nesh. Gara mbetet e hapur, por "Nacional" dëshiron të luaj rol in e saj, në këtë histori të besimit në liri dhe demokraci me përkushtim dhe këmbëngulje.

Askush nga ne nuk do të parashikojë se si do të jetë fundi, por ajo që njohim ne është se një grup shkrimtarësh, gazetarësh dhe përkthyesish elitare në Tiranë, Prishtinë, Shkup dhe Diasporë janë bashkuar për t'i dhënë lexuesit shqiptar një revistë letrare, kulturore dhe politike. Nacional nis sot udhën e saj.

Një jetë kulturore e pasur qëndron në themelet e aspiratave të kombit shqiptar për të forcuar besueshmërinë dhe identitetin e vet në një konkurrencë të hapur të kulturave dhe popujve në shekullin XXI. Synimi i kësaj reviste kombëtare është që të sjellë debatin dhe kreativitetin e argumentit, duke zgjedhur bashkëpunimin në vend të "të këqijave" që na ndajnë, duke ofruar plotësinë kulturore në vend të informacionit të sipërfaqshëm.

Dhembshuria dhe dashuria janë vepër e një kombi i cili mbahet fort mbi kulturën e tij si një bekim i zotit që forcon botën dhe afron të ardhmen. Xhon Pejxhi i pati shkruar Tomas Xhefersonit "e dimë se garën nuk e fiton i shpejti, as betejën i forti. A nuk e dini se një engjell kalëron në vorbullën e erës dhe i prin kësaj stuhie."

Urojmë që engjëlli mbrojtës i kombit tonë të çojë ëndrrat tona tek qëllimi i përmbajtjes në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Preshevë, Ulqin e kështu me radhë. Revista "Nacional" synon t'i shërbejë me modesti këtij qëllimi.

Kjo revistë do të jetë e hapur jo vetëm për krijimtarinë më të re, por edhe për pikëpamjet më të gjëra rreth letërsisë, arteve, jetës kulturore në hapësirat shqiptare. Ky bashkëpunim synon të gjallërojë kulturën dhe letërsinë, duke ju përgjigjur sfidave të së ardhmes.

"Nacional" është besimi juaj dhe prona juaj e lirisë së krijimit dhe botimit, për të përsosur shpirtin e kombit dhe forcuar dashurinë ndaj tij, për të krijuar një komb të bashkuar dhe të pasur në drejtësi dhe mundësi.

Nëse nuk ngulitim në mendjet dhe zemrat e fëmijëve tanë dashurinë dhe dijen për kulturën tonë kombëtare, ne do të humbasim dhuntitë e tyre dhe nuk do t'i udhëheqim drejt.

Shembulli i botuesve të shquar kombëtarë do të na udhëheqë në punën tonë modeste, por plot dashuri për kombin dhe artin e tij.

Revista falënderon me mirënjohje ata që bashkëpunuan në numrin e saj të parë, si dhe të gjithë ata që do të bashkëpunojnë në të ardhmen.

Kosova sfidë shqiptare



Përgjatë udhës për tek Nëna

faqe 4

Poetja që përuroi Obamën



faqe 21

Presidenti Barack Obama ngarkoi poeten Elizabet Aleksandër (Elizabeth Alexander) të shkruajë dhe ta recitojë një poezi për përvënjetjen e tij. Është hera e katërt që një poet shkruan posaçërisht dhe e lexon një poezi në një përvënjetje të tillë. Poetja ishte e përgatitur për sfidën. The New York Times shkruante ato ditë se ajo kishte qyryr tek "Zana e Arteve të Bukura" të W. H. Auden dhe në veprën e Gwendolyn Brooks, e para nga afrikano-amerikanët që fitonte Çmimin Pulitzer në poezi. Auden, sipas saj, shtron shumë pyetje të thella rreth mënyrës si ne e kemi përballur historinë, ndërsa Brooks ka pasur shumë ndikim në poezinë e Alexander. Në një intervistë të përmendur nga gazeta në fjalë, Alexander thotë se Brooks është nga ata njerëz që do të kishin dashur të jetonin për ta dëshmuar këtë moment...

Në BRENDËSI

Poezi nga Flutura Aça: Morali është diktaturë

faqe 8

Tregim nga Zija Çela: I biri i Jahos dhe Sofisë

faqe 10

Letra e At Zef Pllumit nga Xhavit Beqiri

faqe 16-17

Ilir Kadia: Vrimat e këmishës së kaltër

faqe 11

Nga Leonard Veizi: Ajo

faqe 12-13

Nga Vehbi Miftari: Kritika dhe moderniteti

faqe 15

Gjek Marinaj, kumtari i poezisë shqipe

faqe 20

Robert Frost i pari poet i presidentëve

faqe 22

NGA SKËNDER BUÇPAPAJ

Nuk kishte kaluar shumë prej kur Millosheviçi ia hiqte dhunshëm Kosovës autonominë e fituar më 1974, kishte pak kohë prej kur Kosova themelonte pluralizmin e saj, kur Zekeria Cana zbriste në Tiranë. Në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, figura e tij iu kujtonte njerëzve menjëherë kuvendet e famshme të pajtimit të gjaqeve, ku Zekerai spikaste pranë plakut të madh të kombit Anton Çetta. Këto kuvende përjetoheshin me të drejtë si kundërgoditja e parë e fuqishme ndaj Serbisë së Millosheviçit. Kjo ndodhte nëntëmbëdhjetë vjet të shkuara. Zekeriai ishte ende i ri dhe plot energji. Por në opinionin shqiptar mishëronte pleqnarin, njeriun e mendimeve të urta dhe të vendimeve të urta. Ai do të ishte ndër njerëzit e parë, së paku një ndër shqiptarët e parë që do t'ia kërkonte Ramiz Alisë pluralizmin. Dhe ia kërkonte këtë në kontekstin e shpëtimit të kombit, i cili pas ngjarjeve të Kosovës, nëse nuk merrte rrugën e demokracisë, do të ishte viktima më fatkeqe e tërbimeve millosheviçiane. Atëbotë, në një nga mjediset e hotel Dajtit, një mbrëmje të vonë të shtunë, ia merrnim intervistën, të cilën e çonim menjëherë në shtypshkronjë dhe të nesërmen botohej në



Zekeria Cana

gazetën "Drita". Për herë të parë zyrtarisht shahej dhe bëhej pleh "realizmi socialist", të cilit Zekeriai ia vinte epitetin "i mendermethanshëm". Do të ishte ky epiteli, në versionin verior të shqipësisë, që do t'i vihej pastaj shumëçkaje nga trashëgimia e gati një gjysmë shekullit të komunizmit në Shqipëri. Profesorit do t'i përgjigjeshin menjëherë në shtypin lokal partiak të kryeqytetit të Shqipërisë ata që ndiheshin më drejtpërdrejt të prekur në nderin e tyre realsocialist dhe në nderin e tyre klanor. Këtë do ta bënin në rrugë publike. Ndërsa në rrugë shtetërore do të kërkonin përzënia e tij e menjëhershme nga Shqipëria. Pra konsiderimi person i padëshiruar. Ndërkaq në qarqet e mirëfillta intelektuale e akademike, jo pa xheloz, por jo edhe pa realizëm, Zekeria Cana do të konsiderohej një koleg nga më se-

Zekeria Cana ose pleqnari i madh i modernitetit tonë

riozët, që e kishte ndërtuar veprën e tij sa me guxim qytetar, sa me këmbëngulje e zell të pashoq studiuesi, aq edhe me vizion kombëtar e intelektual. Në bisedat që pati me intelektualë, dijetarë e artistë në hotel Dajti, në Muzeun Historik Kombëtar dhe në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, Zekeria Cana për herë të parë, pas dhjetëra viteve, do ta shqiptonte publikisht emrin e Gjergj Fishtës. Atëherë ai tha ndër të tjera se vepra e Fishtës, veçanërisht Lahuta e Malcis, të cilat mësoheshin nga shqiptarët e Kosovës, nga njëri brez në tjetrin, i zëvendësonin shkollat shqipe gjatë pushtimit të rëndë serb. Këtë argument të profesorit unë e përmenda në shkrimin tim në gazetën Drita në dhjetor të vitit 1990, i cili ishte shkrimi i parë afirmues për poetin e madh kombëtar Gjergj Fishtë, i cili iu ishte ndaluar njëllor shqiptarëve në të dy anët e kufirit që prej mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Mesazhi që sillte Zekeria Cana ishte se kombi shqiptar duhej të kapte sa më shpejt trenin e Europës, duhej të merrte sa më shpejt rrugën drejt përdimit, përndryshe do të përfundonte edhe më keq se përgjatë koniunkturave të gati dyqind viteve të fundit dhe do të dënohej me përjashtim politik e fizik përfundimtar nga harta.

Ky burrë energjik, ky gojëtar i rrallë, gjithnjë me dy gishta lart, gishta të ngritur në demonstratat e famshme të Kosovës të viteve 1981-1989, të cilët ne i kishim parë vjedhtas në ekranet e vegjël perëndimorë, do të vinte në redaksinë e gazetës Drita, me një pamje tejet të lodhur e gati të mjerë. Do të përgatiste një letër për Ramiz Alinë, të cilën do t'ia dërgonte atij në dorë në mënyrë të tërthortë. Kjo do të thoshte se atë para largimit nga Shqipëria nuk e priste Ramiz Alia apo dikush nga zyrtarët e tij. Pritja zyrtare e mbërritjes, nëpërmjet së cilës Ramiz Alia donte të fitonte pikë në opinion si përkrahës i Kosovës, do të pasohej me largimin privat e vetmitar të Zekeriaiit nga Shqipëria. Pas fitores së pluralizmit Profesor Zekerai ka ardhur shpesh në Tiranë dhe pothuaj çdo herë ka ardhur në zyrën time në Radiotelevizion ose së paku më ka telefonuar duke m'i thënë arsyet pse po vinte e po largohej kaq shpejt pa më takuar. Ardhjen e tij të parë, intervistën e famshme kundër realizmit socialist dhe letërën private të përgatitur në Drita dhe që ia dërgonte Ramiz Alisë ai e ka përmendur shpesh në shkrimet e tij më vonë. Dhe koha do ta sillte që Zekeria Canën ta kisha një ndër reporterët e gazetës së përditshme të cilën e drejtoja në Perëndim. Nga terreni në Kosovë ai na dërgonte në gazetë reportazhet e luftës. Nuk mund të

ketë pasur ndonjëherë ndonjë media një reporter më të denjë e më të veçantë, më profesionist e më të saktë. Edhe më vonë, sa pati shëndet dhe energji, Zekerai do të vazhdonte të ishte në shërbim të Kosovës, të kombit.

Një nga dëshmitarët e luftës dhe rënies së Jasharajve, bashkëluftëtar dhe i afërm i Adem Jasharit, Gani Geci, në librin e tij "Lufta pa maska", të botuar më 2001, duke përshkruar varrimin e familjes së Jasharajve,, shkruante: "Në varrim kishte ardhur, duke kaluar pengesa të mëdha edhe atdhetari i shquar i çështjes kombëtare profesor Zekirja Cana." Mbjaj mend se në ato ditë të vështira thirrej shumë emri i Zekeria Canës, si një ndër ata burra që mund ta mbanin pa u dobësuar shpirtërisht popullin e Kosovës. Ai ishte sa trashëgimtar i përkryer i pleqnarisë së odave të Kosovës, sa dijetar i shkolluar aq edhe shqiptar me shpirt dhe zemër burrërore. Ish-te një nga pleqnarët më të pashembull të modernitetit të kombit tonë në kapercyellin më vendimtar të fatëve tona, këtë aktual, midis dy shekujve dhe dy mijëvjeçarëve. Zekeriai gjithësesi u largua nga ne para kohe. Por figura të tilla sado vonë të largohen, kurdo që të largohen gjithnjë lënë zbrazëtira të cilat nuk mbushen kurrë.

Gjek Marinaj kumtari i poezisë shqipe

Librin e ri "Lutje në ditën e tetë të javës" të Gjekë Marinajt, pas një leximi të plotë, e kam rilexuar shumë herë gjatë kësaj kohe në cikle e poezi të ndryshme të tij. Horaci dikur thoshte: "Ashtu si piktura është edhe poezia: disa pjesë do t'ju prekin më shumë nëse i shikoni nga afër dhe disa të tjera nëse i shikoni nga larg: dikush e do të errëtën; dikush, që nuk ka frikë nga gjykimet e rrepta të kritikëve, parapëlqen të shihet në dritë; një piktorë (poezi) do t'ju pëlqejë menjëherë, tjetra do t'ju japë kënaqësi pasi ta kesh parë dhjetë herë." Poetët unë i ndaj në dy grupime të mëdha, në dy raca: raca e poetëve që, në njëfarë stadi, e krijojnë ngastrën e vet, përkatësisht mbretërinë e vet, dhe prej atëherë e deri në fund të krijimtarisë, rremon e ndërton brenda kufijve të saj; si dhe raca e poetëve që nuk pushon kurrë së kërkuari, nuk pushon kurrë së zgjeruari hapësirën e vet, mbretërinë e vet. Të parët, duke i kanalizuar saktë-

sisht kërkimet e tyre, ashtu i kursejnë edhe energjitë e tyre, e përkryejnë vetveten brenda një kuadri fort të përcaktuar. Të dytët, kanë ndjeshmërinë (intuitën) se zotërojnë energji të pashterëshme dhe, prandaj, nuk reshtin kurrë së kërkuari, nuk rreshtin kurrë së zgjeruari rrrathët e interesimeve dhe të eksperimentimeve të tyre. Gjekën e përfshij në grupimin e dytë. Ai i përketë asaj race të poetëve që, për arsye të historisë vetjake, për arsye të geneve të tij, për arsye të rrethanave të poezisë që shkruhet atje ku është dhe të asaj që shkruhet prej nga ka ardhur, është i prirur të kërkojë, duke marrë pikënisje e shtysa sa nga përvoja e vet poetike, përherë e më e pasur, aq edhe nga përvojat tradicionale e ato më të ditës në të dyja terrenet. Lexuesi i tij, për të qenë në lartësinë e tillë, nuk duhet të përtojë të shfletojë fjalorët për t'u njohur me fjalë e shprehje që ai i përdor, madje edhe enciklopeditë për rastet ku ai iu referohet termave të fizikës, kimisë, astronomisë, gjeometrisë, filo-



zofisë. Kam përshtypjen se ka qenë nxënës i mirë në shkencat e natyrës. Mendoj se kjo përshtypje të përforcohet më shumë nga libri i tij i ri. Ai kalon

nga një gjendje poetike në një tjetër, nga absurdi në paradoks, nga idealizimi i së bukurës tek estetizimi i së shëmtuarës, nga herezitetë më kryengritëse tek për-

vujtnitë më të skajshme, nga frojdizmi i shfrenuar, tek moraliteti i kulluar, nga mëkatëria më e pafalshme tokësore tek shenjtëria më qiellore, nga ndijmësitë më përvëluese fizike, tek sferat më divine ndijore, nga idilet e buta tek peizazhet makabre. Regjistrat e shumë poetikë i realizon nëpërmjet ndërthurjes së abstraktes me konkretin, duke synuar që t'i ngrejë të dyja këto përmasa në parametrat e abstraktes së kulluar, çka është edhe kredo artistike e të gjithë poetëve modernë, pas Artur Rembosë e deri më sot. Ai thotë "Në trupin e zverdhur të muzgut" (Udhëtim në lundrën e Akerontit). Pra, muzgu i zi bën merr funksionet që do t'i kishin objektet e gjelbëra, kryesisht pylli, bari, gjelbërimi i natyrës në përgjithësi. Kjo mënyrë konceptimi, në një përfytyrim dantesk, të lejon herezinë "Ç'mendonte Vrigjili/Kur e përshkruante ferrin/Si qyteti i Zotit", lejon edhe adresimin në aktualitet, lejon identifikimin e poetit të sotëm me atë antik "Nëse je lindur/Je fajtor./Nëse e lexon këtë mesazh/Je këtu." Thua më tej "Jetojmë me akrobacitë e ndryshimit të çehres" dhe arrin të shprehësh paradoksin e denaturimit të qenies njerëzore, artificializimin dhe automatizimin e tij (Udhëtim për në qendër të vetvetes). E njëjta logjikë poetike se kur thua: "Koha zë në thua,/por jam unë ai që rrezohem,/Jam unë ai që theyej turinjte/...Në ingranazhet e thyer të kësaj ore." Konfuzionin, kaosin modern të e ke shprehur me të njëjtën teknikë të para-

(Vijon nga faqja 20)

doksit, në një kontekst intim, tek poezia "Cilin nga ne jam unë" në librin e mëparshëm "Infinit": "Qenkemi mbrujtur aq epur tek njëri tjetri,/e dashur,/sa kam humbur keq në saktësinë;/cili nga ne jam unë/globit qelqor të dashurisë."

Gjithnjë mendoj se poezia është arti që kërkon më tepër guxim se çdo art tjetër. Këtë mendim ma përforcon libri i ri i Gjekës. Theodhore Roethke kishite pikërisht parasysh këtë kur arsyetonte: "Poezia, madje edhe pak kohë pasi është shkruar,/duket jo më si mrekulli; e pashkruar, ajo duket/Diçka përtej zotësisë së perëndive." Guximi qëndron, pra, në aktin e krijimit, në aktin e shndërrimit të përfytyrimit poetik në poezi të mirëfilltë, aktin e sjelljes së krijimit në jetë, aktin e shndërrimit të lules në frut. ("Ti duhet të besosh: një poezi është diçka e shenjtë - një poezi e mirë/e tillë është," përmbyll Roethke.) Ky akt është i shenjtë deri në çastin kur e merr trajtën përfundimtare, trajtën konkrete, në poezinë e shkruar. Droja përballë këtij akti çon në ngurimet, në stepjet, në të tjera të pafundme si këto, që shpien në dukurinë e poezive të pashkruara, për të cilën ankohen e pendohen shumë poetë. Ky pikëllim e përshkonte Migjenin te "Kangët e pakëndueme". Ashtu siç e thotë edhe Gjeka në poezinë "Bisedë me vdekjen": "Do i laj mëkatet/Për të gjitha poezitë që i lashë të pashkruara,/Dhe për vajzat që në emër të nderit/Dashurinë për mua e lanë të vdesin."

Në librin e ri të Gjekës, nga vuajtjet fizike të objekteve lindin figura të tilla si "Toka nga ndrydhja vesë të kristaltë djersiu", "Horizontit aty pranë prushiu ndezën buzët" (Aferdita). "Nuk ke si të mos i duash vajzat/Që me shikimin e tyre të blertë/Botën e shkujdesur e dritëçajnë në mes," shkruan ai tek poezia "Vajzat". Kështu arrin me sukses të realizojë të lexuesi përfytyrime konkrete përmes abstrakte së shumëfishhtë, ku shikimi blerohet, pastaj me dritën e tij e çan në mes botën e shkujdesur. Kemi në këtë rast edhe krijimin e suksesshëm të një neologjizmi të tillë që ka kuptim vetëm në këtë kontekst poetik dhe askund tjetër: "dritëçajne". Në fondin e stilemeve poetike që i përkasin plotësisht tekstit të tij të ri, pra origjinal, janë edhe "Sytë e tu/ i bëjnë foljet e mia të flasin me vete," apo "efektet anësore të syve të tu" (Sytë e tu); "Dashuria iu fishkëllen njerëzve në vesh" (Qiej të përflakur); "Faleminderit për pjesën tënde të fytyrës sime" (Dusitës, në 14 vjetorin e martesës); "Por fajin mos e shumëzo me numrin e dhëmbëve/Që këtyre dy dekadave iu ka rënë nga pjekuria"; "Përtej dritares/Po të thërret mëngjesi/Të zbardhni bashkë" (Hajku); apo "Retë/Si mjekra kasapësh të vjetër/Ngjyer në gjak/Zbritën në sofrën e malësorëve/Të pinin një pash dritë/Nga dielli i syve të tyre/...Në ikje iu vinte erë varri/Malësorët e mbajnë kryet një spik sipër reve!" (Retë); apo "Perëndim në të dyja kuptimet e fjalës./Gravitet specifik ekstrem:/Kripë dhe shqiptarë./Ujë dhe vdekje" (Flluska mbi Adriatik); apo "Që të mos vdes/takohem përditë aty ku dhemb" (Shqipëri); apo "Sikur të kisha imunitet shpirtëror

200 vjet me Edgar Allan Poe


Eldorado apo El Dorado shpjegohet nga fjalorët e sotëm me pak fjalë: Një vend i begatisë dhe i mirësisë. Një qytet që përfytyrohej të ishte në Amerikën e Jugut, i cili u bë objekt i kërkimit në shekujt XVI e më vonë, pra në shekujt e udhëtimeve të mëdha të zbulimeve gjeografike. Në mënyrë përgjithësuere, në mënyrë metaforike, me Eldoradon kuptohet mirësia dhe begatia përrallore. Eldorado është një fjalë që vjen nga spanjishtja, pra nga gjuha e atij populli që ka nxjerrë më shumë udhëtarë të zbulimeve të mëdha të botëve të reja. Fjalë për fjalë do të thotë Vend i Pruarar,

pra vend i artë, i florinjte. Spanjishtja e ka përbërë kështu këtë fjalë: el (nga latinishtja Ill)+dorado, e cila është pjesore e dorar, pra E Pruarara. Në latinisht është deaurum, denga, aurum, flori, pra Prej Floriri.

Enciklopeditë e përshkruajnë eldoradën si një vend përrallor, të kredhur në flori, për të cilin mendohej se shtrihej diku në Amerikën e Jugut, diku midis lumit Rio e lumit Amazona, si dhe ultësirës së Orinokos, pikërisht afër Bogotës. Legjenda lindi me sa duket nga zakoni i banorëve vendas (indigjenë) të Kolombisë, pikërisht fisit Muysca, për të zhytur në liqene të shenjtë çdo prift të ri (chibcha, quhej ai, shqiptuar zipa) që emërohej në vendin e tyre, të cilin e mbulonin paraprakisht në pluhur floriri. Njerëzit kështu besonin se ai do të ishte me këmbë të mbarë dhe do t'iu sillte pasuri të pafundme. Ky zakon që më vonë u mitizua vazhdoi edhe disa kohë pas pushtimit të vendit nga spanjollët. Kjo legjendë frymëzoi ekspedita të tëra portugeze dhe spanjolle nga Shekujt XVI- XVIII, prej të cilave e famshme është ajo e Pablo de Ursuas, por edhe ekspedita angleze dhe gjermane, në kërkim thesarëve të hatashëm të Perandorisë Omagua. Eldorado u përdor gjerësisht si term për të shprehur mirazhet, pra përfytyrimet tunduese të thesarëve, në mënyrë të veçantë gjatë kërkimit të arit në Amerikën Veriperëndimore, pra në Alaskë, në Shekullin XIX. Ky term pastaj i është përshtatur çdo vendi të pasur. Toponimi Eldorado gjendet sot në shtetin Arkansas të Amerikës, një vend shumë i pasur me burime minerare dhe natyrore. Po ashtu një toponim i tillë gjendet edhe në Kansas po të Amerikës.Kuptohet se këto janë vende reale që i kanë marrë emrat nga vendi i përfytyruar dhe i ëndërruar Eldorado. Për Eldoradon janë shkruar krijime artistike të pafundme. Volteri e ka sjellë legjendën e saj në kryeveprën e tij "Kandidi". Edgar Allan Poe (Boston-SHBA-19.1.1809- Baltimora- 7.10.1849) mendohej se e ka shkruar poezinë më të bukur kushtuar Eldorados. Nuk është e rastit që poezia shqiptare e shkruar në Kosovë e ka trajtuar dendur metaforën e Eldorados në qendër të saj, duke e parë Kosovën si mishërim real të Eldorados për bijtë e saj. Ne po e sjellim, me këtë rast poezinë e Edgar Allan Poes "Eldorado", poezi që është përfshirë në të gjitha antologjitë e poezisë në anglisht të hartuara ndonjëherë. Po e sjellim në origjinal dhe të shqipëruar.

në Shqipëri/Do mbaja për vete pa turp kripën e lotëve"; apo "Shkruar diku midis/ botanikës dhe anatomisë së dy gjetheve" e "Dhe përfundimisht lëshoi mbi gjoks/Si dy fletë të shkëputura Bible/Duart e saj të ndershme mbi njëra tjetrën" (Nëna e poetit Luigj Çekaj dha shpirt) apo "Që konformizmi t'u mbetej më i shtrenjtë se ëndërra/Që ta dinin se, si poetë, edhe fjalët kanë qafë./Se, para ose pas tyre, edhe ato mund të vareshin në litar" (Ailuropoda në gjyqin e fjalës); apo "Që atë mëngjes/Filxhani im i kafesë/Avullon gjak e lot" (Ankth); apo "Arusha e vetme e veshi shpellën me mure durimi/Dhe pas dy javësh u kthye në një grua shifrore./ E ditur se shenjat e numrave romakë nuk kishin zero."

Të tilla figura poetike do t'i kishte zili çdo poet. Por edhe poezi si "Të gjitha juritë do të më falnin", "Moment frojdian", "Dashuria", "Kjo është ajo vajza", "Në ditëlindjen e nënës", "Himn për prindërit e mi", "Mall për nënën", "Shkodrës", "Gonxhe Bojaxhiu", "Rrëfimi i Rozafës", "Sipas meje", "Si do të na vajtonte gjyshja ime ne emigrantëve më 1990-tën", "Shqipëri", "I pa imunitet në Shqipëri", "Vijë ndarëse me Emily Dickinson-in" etj. Më afër lexuesit shqiptar mendoj që janë ciklet "24 orë dashuri", "Lutjet e së dielës", "Duart e nënës", "Rrëfimi i Rozafës", "Sugjerim me zë të ulët". Frederik Reshpja, për të cilin Gjeka ka një poezi, më thoshte dikur në Shkodër (në fillim të viteve 1970) se poetët e



ELDORADO

Gaily bedight,
A gallant knight,
In sunshine and in shadow,
Had journeyed long,
Singing a song,
In search of Eldorado.

But he grew old-
This knight so bold-
And o'er his heart a shadow
Fell, as he found
No spot of ground
That looked like Eldorado.

And, as his strength
Failed him at length
He met a pilgrim shadow-
"Shadow," said he,
"Where can it be-
This land of Eldorado."

"Over the Mountains
of the Moon,
Down the Valley of the Shadow,
Ride, bodily ride",
The shade replied, -
"If you seek for Eldorado!"

ELDORADO

Një trim i ngratë,
Kalorës me shpatë,
Në pishë të diellit e hije kahmos,
Ngado kalëroi,
Me këngë në gojë,
Në kërkim të Eldorados.

Por një ditë u plak-
Kalorësi harrakat-
Dhe nën një hije u fundos
Zemra e tij kur s'u gjend
Askund ai vend
Që t'i ngjante Eldorados

Dhe kur shpirti i vet
Po i shteronte krejt
Një hije atij iu kanos-
"Hije", i tha asaj,
"Ku bie vallë
Rruga drejt Eldorados?"

"Në ato male andej
Sipër Hënës përtej,
Poshtë Lugut të Hijëve semos,
Pra, me guxim rend ti,
Tha hija përsëri,-
Në kërkim të Eldorados!"

E përktheu: E.B

Veriut duhet të bazohen shumë në Eposin e Kreshnikëve. Frederiku vetë, sado që ishte i përfshirë në jetën qytetëse të Shkodrës, është përpjekur të kërkojë në këtë drejtim, sidomos në vëllimin e parë "Rapsodi shqiptare", por edhe në vëllimet e tjera poetike, madje edhe në romanin e tij të vetëm të botuar. Në Kosovë u kuptua menjëherë kjo prirje e Frederik Reshpjes kur atij iu përgatit dhe iu botua në Prishtinë vëllimi me poezi të zgjedhura "Enisë". Frederiku është një ndër poetët më të vuajtur që kam njohur. Një shpirt i artistit të kulluar në një fizik plot drama nga më të egrat, dhe në një jetë plot proza, nga më të skajshmet. As ai, as ne poetët e tjerë të Veriut nuk e patëm të lehtë të brumosemi në poezinë mod-

erne nëpërmjet Eposit të Kreshnikëve, për arsye të realizmit socialist dhe frymës së krahinore popullore (të realizimit socialist) të dekretuar nga lart. Poetët e Kosovës, edhe ata, u tunduan nga zanat e veta. I vetmi që i qëndroi fanatik frymës së Veriut, duke qenë një evropian i mirëfilltë, një shqiptar i kulturuar, ishte Martin Camaj. Edhe Gjeka Marinajt, për rrethanat e mëparshme e të mëvonshme nëpër të cilat ka kaluar, nuk mund t'i mëtoj ta mbajë penën të ngjyer në botën e mitologjisë së Veriut. Gjithsesi uroj të jetë një zë i shquar shqiptar në perëndimin amerikan dhe një ambasador i pashoq i poezisë shqiptare atje, mision të cilin asnjë autor shqiptar nuk e ka kryer deri sot në botën e huaj. **S.Buçpapaj**